

Mundësi për Bashkitë për aplikim në Thirrjen e 8-të të Interreg Euro-MED

1. Synimi i thirrjes

Programi Interreg Euro-MED ka hapur Thirrjen e 8-të për Propozime, e cila mbështet **Projekte Testuese Tematike (Thematic Test Projects)** në kuadër të prioritetëve “Mesdheu më i zgjuar” (Smarter Mediterranean) dhe “Mesdheu më i gjelbër” (Greener Mediterranean).

Tema udhëzuese e kësaj thirrjeje është “Forcimi i qëndrueshmërisë territoriale (Advancing territorial resilience), me fokus forcimin e qëndrueshmërisë dhe reziliencës së territoreve mesdhetare.

Thirrja synon projekte të gatshme për zbatim, të cilat testojnë në kushte reale zgjidhje, strategji ose plane veprimi dhe demonstrojnë se si këto mund të përdoren, përshtaten ose zgjerohen në territore të tjera mesdhetare. Projektet duhet të adresojnë një nevojë të qartë territoriale dhe të jenë të lidhura me strategji, plane ose politika ekzistuese.

2. Çfarë projektesh do të mbështeten?

Thirrja 8 mbështet ekskluzivisht **Projekte Testuese Tematike**. Këto projekte duhet të zbatojnë dhe testojnë zgjidhje konkrete, strategji ose plane veprimi në kushte reale, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të tyre dhe përgatitjen për përdorim, transferim ose zgjerim në territore të tjera.

Në këtë kuadër, aktivitetet mund të përfshijnë zhvillimin dhe testimin e zgjidhjeve nëpërmjet veprimeve pilot, monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të pilotimit dhe hartimin e planeve për transferimin ose përsëritjen e rezultateve.

Një element i rëndësishëm është se këto nuk janë projekte të fokusuara vetëm në kërkim, planifikim ose studime. Pjesa kryesore e projektit duhet të jetë **zbatimi praktik dhe testimi në terren**, me rezultate konkrete dhe të matshme.

Projektet duhet të jenë të pjekura që në momentin e aplikimit, duke pasur të përcaktuara territorin ku do të zhvillohet pilotimi, zgjidhjen që do të testohet, burimet e nevojshme dhe, kur është e nevojshme, procedurat e prokurimit, lejet dhe marrëveshjet për zbatimin.

3. Cilat janë fushat që mund të mbështeten?

Thirrja 8 përfshin tre misione tematike dhe tre objektiva specifike.

3.1. Forcimi i një ekonomie inovative dhe të qëndrueshme

Ky mision lidhet me:

SO 1.1 – Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve kërkimore dhe inovative dhe përdorimi i teknologjive të avancuara

dhe

SO 2.6 – Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe efikase në përdorimin e burimeve.

Në këtë fushë projektet duhet të fokusohen në një nga tre temat e përcaktuara nga thirrja:

- reduktimi i ndotjes së ajrit në sektorin e ndërtimit;
- reduktimi i ndotjes së ujit në sektorin agroushqimor;
- reduktimi i ndotjes plastike të ujit.

Projektet mund të testojnë, ndër të tjera, teknologji ose procese inovative, modele të qëndrueshme biznesi, zgjidhje për reduktimin dhe monitorimin e ndotjes, modele të ekonomisë qarkulluese, ripërdorimin e ujit, ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve dhe strategji ose plane veprimi për ekonominë qarkulluese.

3.2. Mbrojtja, restaurimi dhe valorizimi i mjedisit natyror dhe trashëgimisë

Ky mision mbështetet në:

SO 2.7 – Përmirësimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes.

Projektet duhet të fokusohen në njërin nga dy temat:

restaurimi i ekosistemeve ose rezilienca e biodiversitetit.

Mund të mbështeten ndërhyrje konkrete për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara, restaurimin e liqeneve, lumenjve, ligatinave dhe ekosistemeve bregdetare e detare, metodologji të përbashkëta, sisteme monitorimi dhe platforma për shkëmbimin e të dhënave.

Në fushën e biodiversitetit mund të zhvillohen dhe testohen protokolle për monitorimin e specieve dhe habitateve, mjete për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, zgjidhje për menaxhimin e burimeve natyrore ndërkufitare dhe plane veprimi për mbrojtjen e specieve dhe habitateve prioritare.

3.3. Promovimi i zonave të gjelbra të jetesës

Ky mision lidhet gjithashtu me **SO 2.7** dhe fokusohet në zgjidhje të bazuara në natyrë dhe në komunitet për zonat urbane dhe periurbane.

Në Thirrjen 8 janë përcaktuar dy tema:

mirëqenia dhe shëndeti në zonat e banimit dhe bujqësia urbane dhe sistemet ushqimore reziliente.

Për mirëqenien dhe shëndetin mund të zhvillohen dhe testohen zgjidhje që lidhin reziliencën urbane, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, mjedisin dhe shëndetin publik. Fokusi mund të jetë edhe te pabarazitë shëndetësore, drejtësia sociale, monitorimi i faktorëve të rrezikut dhe përfshirja e qytetarëve.

Për bujqësinë urbane mund të mbështeten infrastruktura të gjelbra multifunksionale, hapësira produktive urbane dhe periurbane, modele të menaxhimit të përbashkët, sisteme territoriale të qëndrueshme ushqimore, mekanizma të pjesëmarrjes së komunitetit dhe mjete për menaxhimin e politikave ushqimore territoriale.

4. Çfarë duhet të prodhojë një projekt?

Projektet duhet të gjenerojnë rezultate konkrete që mund të përdoren edhe përtej territorit ku zhvillohet pilotimi.

Në varësi të objektivit specifik, rezultatet mund të jenë zgjidhje, strategji ose plane veprimi. Zgjidhjet mund të përfshijnë metodologji, mjete, teknologji, shërbime ose marrëveshje bashkëpunimi. Ato duhet të zhvillohen me pjesëmarrjen e të paktën dy partnerëve nga zona e bashkëpunimit, të testohen në kushte reale dhe të jenë të transferueshme.

Për një bashki, kjo do të thotë se projekti duhet të çojë në një **zgjidhje konkrete të testuar në territor**, për shembull një metodologji të re, një shërbim, një teknologji, një sistem monitorimi, një model menaxhimi, një plan veprimi ose një praktikë të re institucionale.

Rezultatet nuk duhet të mbeten vetëm në nivelin e një aktiviteti lokal. Ato duhet të kenë dimension transnacional dhe potencial për t'u përdorur ose përshtatur edhe nga territore dhe organizata të tjera.

5. Kush mund të përfshihet?

Përfituesit dhe palët e interesuara kryesore të aktiviteteve dhe rezultateve të projektit duhet të identifikohen qartë në secilin propozim. Grupet kryesore të synuara në të gjitha misionet zakonisht përfshijnë **autoritetet publike (kombëtare, rajonale, lokale) dhe agjencitë e tyre**, pasi ato shpesh luajnë një rol kyç në zbatimin ose integrimin e zgjidhjeve. Në varësi të fokusit të projektit, grupet e synuara të rëndësishme mund të përfshijnë gjithashtu: ofruesit e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (p.sh., shërbimet publike, agjencitë e transportit), bizneset dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (veçanërisht për projektet në inovacionin ekonomik dhe ekonominë rrethore), shoqërinë civile dhe grupet e komunitetit (veçanërisht për angazhimin e qytetarëve në zonat e gjelbra të jetesës), institucionet kërkimore dhe arsimore (për inovacionin dhe ndërtimin e kapaciteteve) dhe publikun e gjerë ku ndërgjegjësimi publik dhe ndryshimi i sjelljes është i rëndësishëm.

Në detaje, grupet e synuara janë:

- Autoritetet publike që kanë kompetencë të drejtpërdrejtë në menaxhimin administrativ ose operacional të temës së zgjedhur
- Agjencitë sektoriale
- Ofruesit e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- Grupet e interesit duke përfshirë OJQ-të
- Subjektet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor
- Qendrat dhe shkollat e arsimit/trajnimit
- Ndërmarrjet, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
- Publiku i gjerë.

6. Çfarë partneriteti kërkohet?

Partneriteti duhet të përbëhet minimalisht nga **5 partnerë nga 5 vende të ndryshme** të zonës së bashkëpunimit Interreg Euro-MED.

Partneri kryesor, Lead Partner, duhet të jetë një organ publik ose një subjekt i së drejtës publike, sipas përkufizimit të Direktivës 2014/24/BE.

Partnerët duhet të kenë kompetencë të drejtpërdrejtë në fushën që trajton projekti dhe në zbatimin e politikave përkatëse. Ata duhet të kenë gjithashtu kapacitetin për të zbatuar aktivitetet pilot, përfshirë të drejtën mbi territorin, tokën ose objektin ku do të zhvillohet ndërhyrja, ose një marrëveshje ekzistuese me pronarin përkatës.

Programi rekomandon një partneritet të menaxhueshëm, orientueshëm rreth **8–10 partnerëve**, duke vlerësuar pozitivisht edhe balancën gjeografike.

Institucionet që dëshirojnë të marrin pjesë pa kontribut financiar mund të përfshihen si **Associated Partners** dhe nuk llogariten në numrin minimal të partnerëve.

7. Sa është buxheti?

Thirrja ka një buxhet total indikativ prej rreth **20 milionë euro**, nga të cilat: **16 milionë euro** janë fonde Interreg dhe **4 milionë euro** janë bashkëfinancim kombëtar.

Parashikohet përzgjedhja e rreth **10 projekteve**.

Buxheti maksimal për një projekt është **2 milionë euro**, ndërsa kohëzgjatja maksimale është **24 muaj**. Për këtë thirrje nuk parashikohet zgjatje e periudhës së projektit.

8. Si bëhet aplikimi?

Aplikimi zhvillohet në **dy faza të njëpasnjëshme**:

Faza e parë është aplikimi me shkrim përmes sistemit Jems: <https://jems.interreg-euro-med.eu> . Faza e dytë është prezantimi me gojë, për të cilin aplikantët e para-përzgjedhur duhet të përgatisin një prezantim PowerPoint.

Formulari i aplikimit duhet të krijohet dhe plotësohet në Jems dhe mund të dorëzohet në anglisht ose frëngjisht. Seksioni A.2 “Summary” duhet të jetë i plotë në të dyja gjuhët.

9. Si do të vlerësohen projektet?

Vlerësimi zhvillohet në dy faza eliminuese.

Në fazën e parë vlerësohet aplikimi me shkrim. Projektet që arrijnë të paktën **24 pikë nga 35** mund të para-përzgjidhen për fazën e prezantimit me gojë, ndërsa maksimumi 30 projektet e renditura më lart mund të ftohen në këtë fazë.

Në fazën e dytë, prezantimi me gojë vlerësohet deri në **25 pikë**. Rezultati maksimal i përgjithshëm është **60 pikë**, ndërsa pragu për rekomandimin për financim është **42 pikë nga 60**. Përzgjedhja përfundimtare bëhet nga Komiteti i Monitorimit, duke marrë parasysh rezultatit e përgjithshëm, renditjen, pozicionet e delegacioneve kombëtare dhe fondet në dispozicion.

10. Çfarë duhet të bëjë një bashki shqiptare?

Për një bashki shqiptare, pika e parë është identifikimi i një **problemi konkret territorial** që lidhet drejtpërdrejt me një nga tre misionet e hapura në këtë thirrje.

Bashkia duhet të ketë një territor ku zgjidhja mund të testohet realisht, një nevojë të dokumentuar dhe një kompetencë të qartë institucionale për zbatimin e ndërhyrjes. Projekti duhet të jetë i lidhur me strategji, plane ose politika ekzistuese dhe të ketë rezultate që mund të përdoren edhe nga territore të tjera.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është **gatishmëria për zbatim**. Programi kërkon që projektet të jenë të pjekura që në fazën e aplikimit dhe të mund të kalojnë shpejt nga projektimi në zbatim. Për këtë arsye, përpara aplikimit duhet të jenë menduar edhe çështje të tilla si vendi i pilotimit, burimet, procedurat e prokurimit, lejet dhe marrëveshjet e nevojshme.

Gjithashtu, çdo projekt duhet të planifikojë të paktën **një aktivitet trajnimi** që do të kontribuojë në Interreg Euro-MED Academy dhe në zhvillimin e aftësive për tranzicionin e gjelbër dhe digjital.

11. Kur është afati i fundit

Afati për dorëzimin e formularit të aplikimit është **13 nëntor 2026, ora 13:00, sipas orës së Brukselit**.

Dokumentet dhe anekset e detyrueshme duhet të ngarkohen në Jems deri më: **27 nëntor 2026, ora 13:00, sipas orës së Brukselit**.

12. Linku i thirrjes

<https://interreg-euro-med.eu/en/call-8-thematic-projects>